



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Dardaniaa” Sh.P.K. të datës 23.10.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 17.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Parku në Kalabri – faza I mobilizimi dhe demolimi i strukturave të betonit” me nr. të prokurimit 616-23-8866-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Dardaniaa” Sh.P.K. e datës 23.10.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 17.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Parku në Kalabri – faza I mobilizimi dhe demolimi i strukturave të betonit” me nr. të prokurimit 616-23-8866-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “Dardaniaa” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik “Dardaniaa” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 23.10.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 17.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Parku në Kalabri – faza I mobilizimi dhe demolimi i strukturave të betonit” me nr. të prokurimit 616-23-8866-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

**Pretendimi nr. 1** - *"Ne kemi kërkuar qasje në dokumentet e GOE të rekomanduara për kontratë por AK nuk na ka dhënë qasje me arsyetimin se ato dokumente janë sekrete afariste"*.

**Pretendimi nr. 2** - *"GOE i rekomanduara për kontratë nuk e ka plotësuar kërkesat nr. 1, nr. 2, nr. 3, nr. 4 dhe nr. 5 të kapacitetit teknik dhe profesional"*.

Lidhur me pretendimet ankimor nr. 1, duhet sqaruar se për parashtruesin nuk është aspak kontestues fakti që në rastin konkret dokumentet e ofertës së tenderuesit të rekomanduara janë klasifikuar si sekrete afariste në përputhje me LPP dhe RRPP. Megjithatë për parashtruesin është kontestues vetëm fakti nëse autoriteti kontraktues do të duhej që të ofronte qasje në këto sekrete afariste me rastin e kërkesës së parashtruesit për qasje në dokumente publike. Në këtë drejtim, përmes nenit 10 paragrafit 3 të LPP është përcaktuar se *"Me kërkesën e cilitdo person, autoriteti kontraktues i siguron qasje të menjëhershme dhe të arsyeshme personit të tillë, i cili kërkon të ketë qasje në të dhënat e përshkruara në paragrafin 1. dhe 2. të këtij neni, përveç informatave sekrete afariste..."*. Nga dispozita e cituar më sipër nga LPP mund të konfirmohet se autoriteti kontraktues nuk ka ofruar qasje në sekretet afariste të tenderuesit të rekomanduara pavarësisht kërkesës së parashtruesit duke u bazuar në nenin 10 paragrafin 3 të LPP. Prandaj pretendimi i parashtruesit është i pabazuar në tërësi.

Lidhur me pretendimet ankimor nr. 2 fillimisht duhet sqaruar se parashtruesi në këtë aktivitet të prokurimit është eliminuar si ofertues i papërgjegjshëm pasi që nuk i ka përmbushur kërkesat mbi kapacitetin teknik dhe/ose profesional të përcaktuara përmes dosjes së tenderit. Megjithatë parashtruesi përmes kërkesës së tij për rishqyrtim nuk i konteston arsyet e eliminimit të tij si të papërgjegjshëm mirëpo pretendimet e veta ankimore i parashtron kundër tenderuesit të rekomanduara. Për këtë arsye parashtruesi nuk është fare palë e interesuar në raport me pretendimet e tij ankimore. Përmes nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP përcaktohet se termi palë e interesuar nënkupton *"personin që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilitdo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar"*. Në rastin konkret parashtruesi nuk i konteston arsyet e eliminimit të tij si tenderues të papërgjegjshëm prandaj edhe po të vërtetoheshin pretendimet e tij në raport me tenderuesin e rekomanduara, sërish parashtruesi nuk do të mund të shpallej fitues i këtij aktiviteti të prokurimit dhe për këtë arsye nuk mund të argumentoj interes material apo rrezik nga shkeljet e pretenduara. Rrjedhimisht parashtruesi nuk është palë e interesuar në raport me pretendimet e tij ankimore. Sidoqoftë me qëllim të shqyrtimit të plotë të pretendimeve ankimore, vlen të theksohet se janë administruar të gjitha dokumentet me të cilat ka ofertuar tenderuesi i rekomanduara. Me këtë rast është gjetur se tenderuesi i rekomanduara ka përmbushur të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit duke përfshirë edhe kërkesat me nr. 1, 2, 3, 4 dhe 5 lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional. Rrjedhimisht pretendimi i dytë ankimor është i pabazuar në tërësi, përtej faktit që parashtruesi nuk është palë e interesuar lidhur me këtë pretendim.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet parashtruesit janë tërësisht të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 30.10.2023**

**Visar SHEHU**

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.